

URDHËR
Nr. 255, datë 10.4.2020

**PËR DISA NRYSHIME NË URDHRIN NR. 193, DATË 20.3.2020, “PËR MBYLLJEN
APO KUFIZIMIN E LËVIZJEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7, pika 4 dhe 15, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 193, datë 20.3.2020, “Për kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë” bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 riformulohet si vijon:

“2. Kufizimin e lëvizjes, në të gjitha qendrat urbane të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha kategoritë (këmbësorë, biçikleta, ciklomotorë, motomjete dhe mjete) duke filluar nga ora 13:00 e ditës së shtunë, datë 11.4.2020 deri në orën 05:00, të datës 13.4.2020. Përjashtohen nga ky rregull të gjitha mjetet e transportit të mallrave dhe të produkteve ushqimore, Policia e Shtetit, Forcat e Armatosura, njësitë kritike të shërbimeve shtetërore dhe atyre të kompanive mediatike, si dhe shërbimet në banesë (*delivery*).”.

2. Fjalja e parë e pikës 3 riformulohet si vijon:

“Ndalohet ofrimi i shërbimit ndaj qytetarëve nga të gjitha aktivitetet, përfshirë ato të përcaktuara në pikën 1, dhe në tabelën bashkëlidhur këtij urdhri, duke filluar nga ora 13:00 e ditës së shtunë, datë 11.4.2020, deri në orën 05:00, datë 13.4.2020.”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu